

JORGJI GJINARI

MBI NYJEN E PRAPME TË SHQIPES NË ASPEKTIN E LIDHJEVE GJUHËSORE ILIRO — SHQIPTARE

Ka kohë që gjuhëtarët janë ndarë në mendimet e tyre për prejar-dhjen e gjuhës shqipe. Si dihet, një palë e mbajnë atë si vazhduese të drejtpërdrejtë të ilirishtes, një palë tjetër, përkundrazi, si vazhduese të trakishtes, disa si një sintezë të trakishtes e të ilirishtes dhe një palë si bijë të dakomyzishtes. Por shihet se, sidomos këto dy dekadat e fundit, teza ilire është vendosur mbi një bazë më të shëndoshë duke u sjellë argumenta më bindës si nga fusha e gjuhësisë, ashtu edhe nga fushat e historisë, të arkeologjisë dhe të etnografisë.

Një hallkë tjetër e vargoit të copëtuar dhe të humbur nëpër shekuj që lidh shqipen me ilirishten besojmë se mund ta gjejmë te nyja, veçanërisht te nyja e prapme.

Problemi vështirësohet nga që prej ilirishtes dhe prej trakishtes nuk janë ruajtur tekste, sado të gjymtuara, ku të shihet nëse të dyja këto gjuhë ose njëra prej tyre të ketë qënë e pajisur me nyje (të prapme) e me një pjesë të ligjëratës të afërt me të për nga funksioni. Megjithatë, burimet e nyjes së shqipes mund të gjenden me rrugë të tjera. Së pari, për të njohur moshën e nyjes ndihmon ndjekja e historisë së brendshme të saj në këtë gjuhë, analiza e fakteve, duke u nisur nga gjendja e sotme e duke shkuar deri në faza më të hershme ku duken fillimet e saj, ndihmon krahasimi i të dhënave të shqipes me të dhënat e gjuhëve të tjera të Ballkanit që janë të pajisura me nyje të prapme dhe historia e marrëdhënjeve të këtyre gjuhëve. Së dyti, për të gjetur nëse gjeneza e nyjes së shqipes lidhet me ilirishten, me trakishten a me një gjuhë tjetër të vjetër të Ballkanit, mbështetemi në të dhëna të tërthorta që ndriçojnë ndonjë çështje të strukturës gramatikore të atyre gjuhëve dhe pikërisht strukturën e rendit të fjalëve në një tog të përbërë nga një emër dhe nga një atribut. Kjo strukturë ka rëndësi në këtë rast, sepse me të janë të lidhura kushtet gjuhësore në të cilat lindi nyja e prapme në gjuhën shqipe.

Duke qënë se nga gjuhët e sotme të Ballkanit me nyje të prapme, përveç shqipes, janë të pajisura edhe rumanishtja dhe bullgarishtja e maqedonishtja, është e domosdoshme që të vërtetohet së pari nëse kjo nyje në gjuhën shqipe ka një burim të brendshëm, apo është një ndikim i gjuhëve të tjera të Ballkanit.

Për të arritur këtu, historia e nyjes në gjuhën shqipe duhet parë bashkë me historinë e nyjes në gjuhët e tjera të Gadishullit ballkanik, sepse, në këtë pikë, duke përjashtuar greqishten, ato ngjajnë shumë dhe nuk janë pa lidhje me njera tjetrën.

Nyja e prapme me të gjitha këto gjuhë paraqitet e formuar dhe e konsoliduar mirë, ajo kudo ka një funksion të njëjtë dhe të përcaktuar.

Dallimet vijnë më tepër nga që nyja e prapme diku del me një shtrirje më të madhe përdorimi dhe diku me një shtrirje më të vogël. Në gjuhën shqipe ajo është shtrirë më shumë se në gjuhët e tjera. Rumanishtja¹ dallohet në këtë rast prej shqipes, sepse te ajo zakonisht nuk marrin nyje të prapme emrat e personave të gjinisë mashkullore dhe herë-herë edhe emrat topikë. Bullgarishtja² dhe maqedonishtja largohen disi më tepër prej shqipes, ngase ato nuk e përdorin nyjen e prapme në të gjitha emrat e përveçëm (antroponime e toponime), në emrat e farefisnisë kur janë të shoqëruar me një përemër pronor, në etnikonet, në dy emra të lidhur me lidhëzën bashkërenditëse *u -i*), zakonisht në emrat me parafjalë dhe në ndonjë rast tjetër.

Shqipja dhe rumanishtja janë të pajisura edhe me nyje të përparme, kurse në bullgaro-maqedonishte kjo nyje mungon (por, në përshtatje me natyrën e strukturës së saj, bullgaro-maqedonishtja ka sajuar nyje të prapme për disa raste ku shqipja dhe rumanishtja kanë nyje të përparme, p.sh. te mbiemrat dhe disa pjesë të tjera të ligjëratës me funksione mbiemri: *работният народ, мојот, мојота едината, петата* te numërorët e totalitetit: *трите* (të tre etj.). Në përdorimin e nyjes së përparme midis shqipes dhe rumanishtes ka një dallim esencial, sepse në gjuhën shqipe mbiemri me nyjen e përparme kanë formuar një tërësi të veçantë, një njësi leksiko-gramatikore, që funksionon jo vetëm si atribut, por edhe si predikat: *njeri i mirë*, dhe: *ai është i mirë, djalin e ke të mirë, çajin e pi të nxehtë* etj., kurse në rumanishte nyja para mbiemrit përdoret vetëm kur ky i fundit është në bashkëvajtje me emrin në funksion atributiv: *omul cel bun*. Përveç kësaj, shqipja dallohet në këtë rast prej rumanishtes edhe për faktin se nyja e përparme në gjuhën shqipe ka një përdorim shumë më të madh, aty me nyje të përparme janë të pajisur edhe përemrat lidhorë, përemrat e pakufishëm, numërorët e totalitetit, disa emra të farefisnisë (*i ati, e ëma, i unguj* etj.), në dialekte emrat etnikë (*i bot, i grudë, i zhulat, i mirdits* etj.) dhe në disa raste të tjera.

Ngjashmëria e madhe që shihet në punë të nyjes tregon qartë se në këtë rast këto gjuhë nuk janë takuar rastësisht pas një zhvillimi krejt të pavarur të nyjes në secilën prej tyre. Dallimet që vërehen midis shqipes dhe rumanishtes në masën e përdorimit të nyjes së përparme janë shpjeguar prej E. Çabejt³ si rezultat i zhvillimit të brendshëm pas ndërprerjes së kontakteve të këtyre dy gjuhëve. Mungesa e nyjes së përparme në bullgarishte e maqedonishte është e lidhur me strukturën specifike të tyre, te ato atributi nuk vjen në rend pas emrit, por para emrit (*dobrijot čovek*, kurse në shqipe dhe në rumanishte është krejt ndryshe, aty gjejmë strukturën *emër + atribut* (*njeri i mirë; omul cel bun*). Ishin këto kushte të veçanta që bënë të zhvillohej nyja e përparme prej nyjes së prapme në shqipe dhe në rumanishte. Për karakterin sekondar të proklizës dhe lindjen e saj nga enkliza në këto dy gjuhë

1) *Gramatica limbii române* I, edic. a II-a, Bucuresti, 1963, ff. 98-104.

2) St. Mihajlov, *Kriticen pogled verbu balgopskie ezik, gramatikata i pravopis*, Lausanne, 1970, f. 63-66.

3) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në *Bul. i USHT*. — SSSH, 3, 1963.

janë shpjeguar qartë dhe kanë sjellë argumenta bindës, E. Çabej⁴ për gjuhën shqipe dhe I. Kotesnu⁵ për rumanishten.

R. G. Petrovski⁶ (shih shënimin tonë), pa njohur historinë e shqipes në përgjithësi dhe të nyjes së saj në veçanti, ka hedhur mendimin se nyja e prapme në gjuhën shqipe është e re, e formuar aty midis shekujve XII dhe XV si rezultat i ndikimit të një gjuhe sllave të Ballkanit (d.m.th. të bullgaro-maqedonishtes) ose të një gjuhe romano-ballkanike.

V. Pissani⁷ në kumtesën e Konferencës II të studimeve albanologjike, mendon vetëm për një huazim si mjet gramatikor të nyjes *a* nga *u* (< ul) e romanishtes ose edhe të nyjes *i* nga *illi* e latinishtes, por edhe ky mendim nuk qëndron dot pas vërejtjeve shumë bindëse të Sh. Demirajt⁸ dhe VI. Georgievit.⁹

VI. Georgievi,¹⁰ pa mohuar origjinën shumë të lashtë të nyjes në gjuhën shqipe, ka shfaqur mendimin mbi mundësinë e përdorimit të formës së skajuar në këtë gjuhë nën ndikimin e artikullit të greqishtes. Ndikimi i mundshëm i greqishtes në këtë rast nuk gjen dot shpjegim të mbështetur mirë, sepse, përveç të tjerave, nyja e greqishtes është prepozitive (Ο ἀνδρωπος), kurse ajo që përdor shqipja për skajimin e emrave është postpozitive (*njeri-u*).

Për të vërtetuar moshën e lashtë të nyjes së prapme në gjuhën shqipe ka prova të ndryshme që dalin prej historisë së zhvillimit të shqipes nga një fazë në tjetrën.

4) Po ai, *po aty*.

5) I. Coteanu, *Despre pozitia erticolului in limba româna*, në «Studii, si cercetari linguistice», 1-2 1956. f. 57-71.

6) R. G. Piotrovskij, *O sravnitelnoj hronologii postpozicii opredelenogo artiklja v tak nazvyvaemyh balkanskijh jazykah*, 1960, f. 16.

Shënim: Për të mbështetur tezën e vet R. G. Piotrovski, ka sjellë si argumenta disa emra topikë dhe emra personash kompozita nga onomastika e vjetër e shqipes në të cilat ai nuk sheh nyje të prapme tek komponenti i parë i kompozitës: *Valbona* (lat. Vallisbona), *Burmasi* (Burrmadhi), *Bukomiri* (Bukëmiri) etj. Këta argumenta nuk qëndrojnë, sepse, po të njëhej për së afërmi specifika e shqipes, do të shihej se ajo jo vetëm kompozitat, por edhe një tog të përbërë nga një emër dhe një mbiemër (llagap) i merr si një njësi dhe shquan kështu me nyje të prapme vetëm pjesën e dytë të kompozitës: *Qishëbardhë*, *Qafëmolla*, *gushëkuqi*, *leshziu*, dhe *Fatmir Bregu*, *Dile Prenga*, deri edhe *Pjetër Bibdoda*, *Kolë Gjideda* edhe *Mark Cub Lleshi*, *Lesh Gjon Kola* etj. Edhe huazimet e rumanishtes prej shqipes që dalin të panyjzuar nuk qëndrojnë si argumenta, sepse duhet marrë parasysh se si shqipja edhe rumanishtja kanë trajtë të shquar, të pashquar. Ky gjuhëtar vazhdon më tej të sjellë shembuj të tjerë për të provuar se në kohën, kur nuk ishin prerë ende kontaktet shqiptaro-rumune, ekzistonte vetëm nyja e përparme, kurse nyja e prapme nuk kishte zënë vend. Fjalët *terc* (çark), *ciunt* (çunt), *tupata* (çupatë), të sjella si argument në këtë rast. R. G. Piotrovskij i interpreton si fjalë me nyje të përparme: *të thark*, *të shut*, *të sëpatë*. Një interpretim i këtillë është krejt i gabuar, sepse struktura e gjuhës shqipe as ka njohur dhe as njej fjalë të këtij tipi me nyje të përparme, ato në të vërtetë janë respektivisht fjalët e shqipes së sotme: *thark-u*, *shytë-shyta*, *sëpatë-sëpata* ose *supata* (dialektore).

7) V. Pissani, *Nyja e mbrapme në shqipen dhe çështje të lidhura me të*, në «Konferenca II e studimeve albanologjike», vëll. III, Tiranë, 1969, f. 123-125.

8) Sh. Demiraj, *Diskutimi rreth kumtesës së V. Pissanit*. «Nyja e mbrapme në Shqipen dhe çështje të lidhura me të», në «Konferenca II e Studimeve albanologjike», vëll. III, f. 325-327.

9) VI Georgiev, *Diskutim rreth kumtesës së V. Pissanit*. «Nyja e mbrapme...», në «Konferenca II e studimeve albanologjike», vëll. III, f. 124.

10) VI. Georgiev, *Le problème de l'anion linguistique balkanique*, në «I Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-est Européennes — Rapport pur la seance leniere», Sofia, 1966, f. 18-19.

la seance leniere», Sofia, 1966, ff. 18-19.

Në dokumentat e parë të shkruar të gjuhës shqipe, që janë të shekullit XV, nyja e prapme del kudo e konsoliduar plotësisht. Po kjo shihet edhe në të dhënat e onomastikës shqipe të shpërndara andej e këtej nëpër dokumenta të huaj të një kohe para shkrimit të shqipes. Koha e këtyre dokumentave të huaj dhe shqip nuk është caku i fundit ku duhet kërkuar mosha e nyjes së prapme të shqipes. Ekzistojnë prova të tjera nga historia e brendshme dhe e jashtme e kësaj gjuhe që e shtyjnë këtë cak shumë shekuj më përpara, deri në një fazë të prehistorisë së zhvillimit të saj.

Së pari, siç thotë edhe Kr. Sendfeld,¹¹ identiteti i nyjes me përemrin përkatës në gjuhën shqipe vihet re më pak se kudo (se në gjuhët e tjera të Ballkanit — J. Gj.). Një identitet i nyjes me përemrin dëftor nga pikëpamja e funksionit gramatikor këtu nuk vihet re jo vetëm sot, por as në dokumentat e parë të shqipes dhe as edhe në të dhëna të tjera gjuhësore që dalin disa shekuj para se të fillonte të shkruhej kjo gjuhë. Edhe diferencimi fonetik i nyjes me përemrat përkatës është kryer herët. Kjo shihet jo vetëm kur krahasojmë trajtat e nyjeve *i, u, e* (që dhe *a* pasi u krye krais me *ë*-në: *fushë+e fushe*), *të* (në emërore) dhe *të, së*, (në rasat oblike) me ato të përemrave dëftorë përkatësisht; *ai, ay, ajo, ata, ato* (në emërore) dhe *ati, asi, asaj, aso* (në rasat oblike), por edhe kur i krahasojmë ato me komponentet e para të përemrave pronorë *y* (*yt, jo* (jote), dhe *te, to* (tanë, tonë), të cilat duket se janë më të hershme se trajtat e dëftorëve me pjesëzën deiktike *a* (*ai, ay, ajo* etj.), e cila u është ngjitur më vonë përemrave me formë më të thjeshtë. Nga kjo pikëpamje edhe dialektet e shqipes nuk shfaqin asnjë dallim prej kohësh.

Lashtësinë e nyjes së prapme të shqipes E. Çabej¹² e sheh në faktin që sipas tij nyja e përparme *e* mund të ketë dalë prej eklitikës *e* (*fushë-e*), në një kohë kur ende nuk ishte kryer krais në grupin *ë+e* që dha *a* (*fushë+e > fusha*). H. Pedersen¹³ origjinën e lashtë të kësaj nyjeje e përcakton nga forma *-n(ë)* e nyjes së kallëzores së shquar (*kalin, shtëpinë*), të cilën si e mendon të zhvilluar nëpër një fazë të mëparëshme me formën *+nd* të dalë nga bashkimi i *n*-së fundore të kallëzores së vjetër me *t*-në e përemrit dëftor: *+snusam + tam*. M. La Plane nyjen *-n* (ë) të kallëzores e bie të formuar para depërtimit të huazimeve latine, duke u mbështetur te rregulli sipas të cilit grupi *nt* i fjalëve latine nuk është asimiluar plotësisht në *n*, por ka shkuar deri në *nd* (p.sh. lat. *conventum > shq. kuvend* etj.) Edhe H. Bariçi,¹⁴ Al. Rosetti¹⁶ dhe Vl. Georgievi¹⁷ e mendojnë shumë të lashtë origjinën e nyjes së prapme të shqipes, pavarësisht se sipas hipotezës së tyre duhet gjetur te trakishtja burimi i kësaj nyjeje.

Në gjuhën rumune nyja e prapme del e formuar dhe e konsoliduar morfologjikisht dhe fonetikut që në fazën e rumanishtes së përbaškët. I. Koteanu,¹⁸ duke u mbështetur në përdorimin e kufizuar në aru-

11) Kr. Sandfeld, në *Balkanfilologien*, 93 (khr. N. Jokl. litteris IX, 206).

12) E. Çabej, *Studime etimologjike*, në *Bul. i USHT, SShSh*, 4, 1961, f. 112.

13) H. Pedersen. *Festschrift til Wilhelm Thomsen*, 1934, f. 249; *KZ*, 36, 310.

14) M. La Plane, *Studi linguistici albanesi*, I, 1939, 29 v.

15) H. Bariçi, *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1965, ff. 39-40.

16) Al. Rosetti, *Istorie limbii române*.

17) Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 20.

18) I. Coteanu, *vep. cit.*, f. 68.

manishte të nyjes së përparme *al* në krahasim me dakorumanishten (ai ka mendimin se prepozitivja *al* doli pasi kishte zënë vend artikulli postpozitiv), nxjerr përfundimin se nyja e prapme ishte formuar në këtë gjuhë para se të ndaheshin gjeografikisht dialektet e saj, d.m.th. para shekullit X. Edhe R. I. Piotrovskij¹⁹ nga të dhënat e onomastikës së vjetër të Ballkanit e sheh formimin e nyjes së prapme në gjuhën romano-ballkanike jo më të vonë se shek. XI. Mendimi që ka E. Çabej,²⁰ se pikat e përbashkëta të shqipes e të rumanishtes në përdorimin e nyjes së përparme, të dalë nga enkliza, janë të periodës kur këto dy gjuhë ende ishin në kontakt me njëra-tjetrën, të çon në përfundimin se nyja e prapme në rumanishte kishte zënë vend mirë para ndërprerjes së simbiozës së këtyre dy gjuhëve (d.m.th. para shek. X-XIII). Sipas Vl. Georgievit²¹ artikulli në rumanishte është zhvilluar ndërmjet shek. VI e X e. re.

Mendimet për burimin e nyjes së rumanishtes janë të ndara: sipas A. Graurit²² ajo është me prejardhje latine, sipas Vl. Georgievit²³ edhe nyja e prapme edhe «kopulativja», duke qenë të një origjine latine, nuk janë veçse *kalke* të përdorimit të artikujve në dakomyzishte, kurse sipas Al. Rosettit²⁴ ato janë rezultat i një ndikimi të substratit dak. Duke qenë kështu nuk mund të mendohet për një ndikim të rumanishtes mbi shqipen në këtë rast, sepse nyja e gjuhës rumune, edhe po të jetë me origjinë latine, e formuar në terrenin e Ballkanit, është më e re në moshë se nyja e shqipes, gjithashtu edhe sikur të jetë më e hershme, e një substrakti të vjetër ballkanik, kemi të bëjmë me një burim të përbashkët, i cili për rumanishten, si një gjuhë neolatine, është substrat, kurse për shqipen jo, sepse te ajo nuk kemi të bëjmë me këmbim gjuhësh.²⁵

Prej bullgaro-maqedonishtes aqë më tepër nuk mund të mendohet një ndikim në lindjen dhe formimin e nyjes së prapme të shqipes, duke qenë kjo nyje në gjuhën shqipe shumë e lashtë, s'ka si të jetë kryer një fenomen i këtillë, kur dihet mirë se bullgarishtja si një gjuhë sllave, zuri vend në ambientin ballkanik jo më parë se shekulli VI i e. re. Për rastin tonë që po trajtojmë nuk ka rëndësi se nyja e prapme në bullgaro-maqedonishte i ka burimet e saj në sllavishten e përbashkët, siç mendojnë L. Miletiçi,²⁶ R. G. Piotrovskij²⁷ e ndonjë tjetër, se mundësia e artikullimit në këtë gjuhë është ruajtur në embrion që nga faza e sllavishtes së përbashkët dhe pastaj është zhvilluar në kushtet e Ballkanit, si janë të mendimit K. Mirçevi,²⁸ J. Gëllëbovi,²⁹ Vl. Georgievi³⁰ e B. Koneski³¹ apo se fillimet e kësaj nyjeje në bullgarishte du-

19) R. G. Piotrovskij, *vep. cit.*, f. 13.

20) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, f. 30.

21) Vl. Georgiev, *vep. e cit.*, f. 20.

22) A. Graur, *Romania*, LV, 1929, f. 475 v.

23) Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 20-21.

24) Al. Rosetti, *Istoria limbii romini*, II, Edic. e -IV, Bucuresti 1904, f. 96 v.

25) Shih E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe* f. 92.

26) Khs. K. Mirçev, *Istorijska na balgarski ezik*, Sofia, 1949, f. 145.

27) R. G. Piotrovskij, *vep. cit.*, f. 16 v.

28) K. Mirçev, *vep. cit.*, f. 145 v.

29) I. Galabov, *Problemet za clena v balgarski i rumanski ezik*, Sofia, 1962, f. 510 (sipas Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 16).

30) Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 16-17.

31) Blaze Koneski, *Istorijska na makedonskiet jazik*, 1965, f. 126-127.

hen kërkuar në mesjetë te rumanishtja ose te shqipja, siç është shprehur A. Grauri³².

Të gjithë këto sjellin bindjen se burimi i nyjes së prapme të shqipes, të rumanishtes dhe të bullgaro-maqedonishtes duhet kërkuar te një e disa nga gjuhët e vjetra të Ballkanit. Të paktën për shqipen kjo është evidente; të këtij mendimi janë shumë nga gjuhëtarët³³ që e kanë trajtuar problemin e nyjes në gjuhët e Ballkanit. Edhe po të mos ketë qenë e formuar që në atë periudë nyja e prapme me tiparet e vete morfologjike dhe fonetike në këto gjuhë të vjetra të Gadishullit ballkanik, është shumë e mundshme që në to të kenë ekzistuar struktura dhe mjetet gjuhësore si një embrion prej të cilit doli dhe u zhvillua pastaj nyja e prapme që duket sot në gjuhën shqipe, në rumanishte dhe në bullgaro-maqedonishte.

Greqishtja e vjetër përjashtohet si një burim i mundshëm, sepse ka pasur nyje të përparme dhe një strukturë të ndryshme nga ajo e shqipes dhe e rumanishtes, përveç kësaj, zhvillimi i nyjes së përparme në greqishte, ndryshe nga shqipja dhe rumanishtja, ka shumë të ngjarë që të ketë qenë e lidhur me kushtet e një emri të veçuar ashtu sikurse në shumë nga gjuhët e sotme të Evropës Perëndimore të pajisura me nyje prepozitive.

Maqedonishtja e vjetër nuk vjen në konsideratë si burim në këtë rast për arsye historike e gjeografike; mbi të gjitha për të ende nuk ka një ide të qartë, sepse ekzistojnë katër hipoteza³⁴ të ndryshme, nga të cilat njëra e konsideron një dialekt të greqishtes, tjetra si gjuhë me origjinë ilire, e treta si gjuhë me origjinë trake dhe e fundit si një gjuhë që shumë herët ka qenë tepër e afërt me greqishten.

Kështu mbeten për t'u marrë në vështrim si burim i nyjes së shqipes dy nga gjuhët e vjetra të Ballkanit: ilirishtja dhe trakishtja (dakomyzishtja, edhe në qoftë se ka ekzistuar si gjuhë më vete ka qenë e lidhur ngushtë me trakishten, siç thotë Vl. Georgievi,³⁵ ose ka qenë një dialekt trak, sipas Al. Rosettit).³⁶

Të dhënat direkte për pajisjen e ilirishtes dhe të trakishtes me një nyje të prapme ose edhe të përparme mungojnë. E. Çabej³⁷ te *Scupi* i kohës antike sheh mundësinë e identifikimit të *i*-së fundore të këtij toponimi me nyjen e prapme *i* të shqipes. E vërtetë është se, duke u shkruar në atë kohë emrat ilirë sipas natyrës së gjuhëve latine dhe greke, vështirësohet mundësia për analizën gjuhësore të këtyre emrave. Vl. Georgievi,³⁸ kur interpreton inskripsionin me shkrim të vijueshëm të unazës së artë të Kzerovit (shek. V p.e.re), mendon për ekzistencën e një

32). A. Graur, *La romanité du roumain*, f. 20 (sipas Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 18).

33) N. Jokl, *Indogermanische Forschungen*, XLIX, f. 274 v.; Baric, *vep. cit.*, f. 39-40; E. Çabej: *Rreth disa çështjeve...*, f. 52; Al. Rosetti, *Istoria limbii romine*, vëll. II, edic. III, f. 96; V. Pissani, *vep. cit.*, f. 24 dhe në *Saggi di linguistica storica*, Torino, 1959, f. 105 v.

34) Shih Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 13-14.

35) Po ai, *po aty*.

36) Al. Rosetti, *L'apport du latin balkanique et du roumain à la constitution de la communauté balkanique*, në «I» Congrès International des Etudes Balkaniques et sud-est Européennes — Rapport pour la séance plénière», Sofia, 1966, f. 35.

37) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...*, f. 39.

38) Vl. Georgiev, *vep. cit.*, f. 20.

nyjeje të prapme në disa fjalë të këtij mbishkrimi trak; por, ai vetë shfaq dyshimin për këtë duke thënë shprehimisht: «*Megjithëse interpretimi i inskripsionit të studjuar nuk mund të konsiderohet krejt si i sigurtë...*» (vazhdon citati).

Duke qënë kështu, mbetet në këtë rast vetëm mundësia e shfrytëzimit të të dhënave indirekte të ilirishtes dhe trakishtes. Një e dhënë e këtillë mendojmë se duhet kërkuar te struktura e një togu a të një emri kompoziti të përbërë nga një substantiv dhe një atribut. Themi kështu, sepse edhe nyjen e prapme të shqipes dhe të rumanishtes e mendojnë të dalë në kushtet e një togu të këtillë; brenda formulës *substantiv + atribut (mbiemër)* e mendojnë për shqipen H. Pedersen³⁹, E. Çabej,⁴⁰ Al. Rosetti,⁴¹ A. Grauri,⁴² K. Mirçevi⁴³ dhe për rumanishten A. Grauri, Al. Rosetti,⁴⁵ K. Mirçevi⁴⁶ si dhe I. Koteanu,⁴⁷ por ky i fundit në formulën *substantiv + atribut* (emër në gjindore). Në një farë mënyre kjo shihet edhe për bullgarishten nga shembuj të teksteve të bullgarishtes së vjetër *сверъпны тѣ/Бѣсе* ose *что оучение се новое* dhe nga fakti që në këtë gjuhë mbiemri del me nyje vetëm kur është i shoqëruar me emrin. V. Pisani⁴⁸ në përgjithësi për gjuhët e Evropës të pajisura me nyje të prapme burimin e kësaj nyjeje e gjen te një substrat shumë i lashtë karakteristikë e të cilit ka qënë vendosja e përcaktuesit pas të përcaktuarit.

Një strukturë e këtillë për shqipen është një tipar specifik, me sa duket,⁴⁹ ajo është edhe një veti konstitutive e saj; gjithashtu edhe për rumanishten kjo strukturë është e zakonshme, ndryshe nga latinishtja dhe gjuhët neolatine.

Për mungesë tekstesh e frazash, qoftë edhe të shkëputura, është vështirë të përcaktohet mirë se çfarë strukture kanë pasur ilirishtja dhe trakishtja, por, megjithatë, ndihmojnë në këtë rast në një farë mase të dhënë nga toponimia e trakishtes.

Sipas VI. Georgievit⁵⁰ për trakishten janë karakteristike toponimet ditematike, *Drizumara* (Drizu+para), *Mesembria* (Mese(m)+bria) *Scelabria* (Scela+bria), *Tyrodize* (Tyro+diza) *Orudiza* (Oru+diza), *Αξιπο* (Αξι+πο) fjalë për fjalë «i zi ujë ose lum» etj. Si shihet, kompozitat e trakishtes kanë strukturën me vendosjen e përcaktuesit përpara elementit që përcaktohet, d.m.th., hyjnë në formulën *atribut + substantiv*, ashtu sikurse greqisht *Ακροπολις* (Ακρο+πολις) ose *ἀγαθος ἄνθρωπος*,

39) H. Pedersen, *Festschrift til Vilhelm Thomsen*, 1934, 248.

40) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...*, f. 84.

41) Al. Rosetti, *Istoria limbii romine*, vëll. II, edic. III, f. 92.

42) A. Greuri; *A. propos de l'article postposé*, në «Romanie», IV, 1929, 475 v.

43) K. Mircev, *vep. cit.*, f. 145.

44) A. Graur, *A. propos de l'article postposé*, 475 v. etj.

45) Al. Rosetti, *Istoria limbii romina*, f. 92.

46) K. Mircev, *vep. cit.*, f. 145.

47) I. Coteanu, *vep. cit.*, f. 65.

48) V. Pisani, *Nyje e mbrapme në shqipen...*, f. 124.

49) Shih. J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe*, në «*Studime filologjike*», 1, 1969, f. 73-75.

50) VI. Georgiev, *Thrace et illyrien*, në «*Linguistique Balkanique*», VI, 1963, ff. 71-74.

rusisht *НОВГОРОД* (Hob + ropoa) ose *ДОБРЫЙ МУЖ*, gjermanisht *Strassburg* (Strass + burg), ose (*der*) *guten Mam* etj. Kompozita të këtij tipi ka edhe e ashtuquajtura dokomyzishtes.⁵¹ *Buridava* (Buri + dava), *Dacidava* (Daci + dava), *Thermidava* (Thermi + dava) etj.

Kjo strukturë e largon shqipen prej trakishtes (në këtë pikë me shqipen afrohet edhe rumanishtja), sepse në gjuhën shqipe gjejmë strukturë me rend të kundërt qoftë në kompozita si *gushëkuq*, *Gurakuq*, *Gruemirë*, qoftë në togje fjalësh: *Mali i Zi*, *Guri i Bardhë*, *njeri i mirë* etj.

Prej kësaj mund të nxirret përfundimi se të paktën trakishtja (edhe dakomyzishtja) nuk është ajo gjuhë e vjetër e Ballkanit ku duhet të kërkojmë burimin e nyjes së prapme të shqipes. Atëhere, nga përjashtimi edhe i trakishtes, duhet menduar se një burim i këtillë ka qenë ilirishtja. Përfundimi që nxorrën këtu ndoshta do të ishte më bindës sikur të kishim edhe të dhëna për ilirishten ku të shihej struktura e renditjes së të përcaktuarit dhe përcaktuesit në një kompozitë e në një tog fjalësh. Por kjo mundësi nuk na jepet dot nga që, së pari, përgjithësisht nuk janë gjetur deri më sot fraza të lidhura të ilirishtes dhe, së dyti, ndoshta, nga që, siç mendon Vl. Georgievi,⁵² edhe emrat nga fusha e onomastikës ilirishtja rregullisht i ka pasur monotematikë (*Zader*, *Scardona*, *Ulcinium*, *Drinus*, *Aetor*, *Bato*, *Plator* etj.), ndryshe nga trakishtja (dhe dakomyzishtja), që ka pasur emra të këtillë kompozita, si *Drizupara*, *Mesembria*, *Tyrodiza*, *Mestikenthos*, *Rescotorme*, *Roimetalkas* etj.

Pas këtij përfundimi mbi burimin e nyjes së prapme në gjuhën shqipe mund t'i shtohet edhe një pikë tjetër mbështetëse provave të sjella nga gjuhësia, historia, arkeologjia dhe etnografia si argumenta të tezës që e mban shqipen të lidhur me ilirishten nga pikëpamja e filiacionit dhe shqiptarët autoktonë në këto anë të Ballkanit ku jetojnë edhe sot.

R é s u m é

A PROPOS DE L'ARTICLE POSTPOSE DE L'ALBANAIS SOUS L'ASPECT DES RAPPORTS LINGUISTIQUES ILIRO-ALBANAIS

Il y a déjà longtemps que les opinions des linguistes sont partagées quant à l'origine de la langue albanaise. Les uns la considèrent comme la continuation directe de l'illyrien, les autres comme celle du thrace, d'autres comme une synthèse du thrace et de l'illyrien, certains autres enfin la font dériver du dacomyzien. Dans ces deux dernières décennies la thèse illyrienne s'est appuyée sur une base plus solide grâce à l'apport d'arguments plus convaincants tant dans le domaine de la linguistique que dans ceux de l'histoire, de l'archéologie et de l'ethnographie.

L'auteur examine, dans sa communication, l'article postposé, considéré un maillon de la chaîne reliant l'albanais à l'illyrien. L'article postposé se présente outre l'albanais, aussi en roumain, en bulgare et en macédonien, bien formé et consolidé. Les différences se font plutôt sur le plan de l'usage: tantôt plus étendu, tantôt moins. Le roumain se distingue dans ce cas de l'albanais: en effet en roumain les noms de personnes de genre masculin et aussi parfois les toponymes

51) Po ai, *La toponymie ancienne de la péninsule Balkanique et la thèse méditerranéenne*, Sofia, 1961.

52) Po ai, *Thrace et illyrien*.

ne prennent pas l'article postposé. Le bulgare et le macédonien s'écartent davantage de l'albanais, du fait qu'ils n'emploient pas l'article postposé dans tous les noms propres, dans les noms de parenté suivis d'un pronom personnel, dans les ethnonymes, etc.

L'albanais et le roumain ont également des articles préposés, qui manquent en bulgare-macédonien. Pourtant, il y a une différence essentielle dans l'emploi de l'article préposé entre l'albanais et le roumain: en albanais l'adjectif avec l'article préposé a formé un tout particulier, une unité lexico-grammaticale, qui fonctionne non seulement comme attribut, mais aussi comme prédicat (*njeri i mirë*, mot à mot: un bon homme), contre une fonction attributive en roumain (*omul cel bun*).

Les différences qu'on constate entre l'albanais et le roumain dans la fréquence de l'usage de l'article préposé ont été expliquées par E. Çabej comme les résultats d'un développement interne après l'interruption des contacts de ces deux langues. L'absence de l'article préposé en bulgare et macédonien est liée à leur structure spécifique. En albanais et en roumain on a le contraire: la structure nom + attribut, et les conditions spécifiques ont amené le développement de l'article préposé à partir de l'article postposé en albanais et en roumain. A propos du caractère secondaire de la proclise et de son apparition à partir de l'enclise dans ces deux langues, des explications claires en sont données par Çabej pour l'albanais et par I. Coteanu pour le roumain.

R. G. Petrovski considère l'article postposé en albanais comme remontant entre les XII^e et les XV^e siècles, à la suite d'une langue slave des balkans; V. Pisani lui considère un *illi* latin; VI. Georgiev considère l'influence possible du grec. Ces hypothèses ne résistent pas à la critique.

Pour attester la grande ancienneté de l'article postposé en albanais on a différentes preuves fournies par l'histoire du développement de l'albanais d'une phase à l'autre. Dans les premiers documents écrits de l'albanais, l'article postposé apparaît partout fortement implanté. Cela se manifeste aussi dans les données de l'onomastique albanaise disseminées un peu partout dans les documents précédant le XV^e siècle. Gjinari affirme qu'il existent d'autres preuves de l'histoire intérieure et extérieure de cette langue qui font reculer de plusieurs siècles cette limite jusqu'à une phase de la préhistoire de son développement.

Une identité de l'article avec le pronom démonstratif du point de vue de la fonction grammaticale ici se remarque non seulement de nos jours, mais aussi dans les premiers documents de l'albanais, et aussi dans d'autres données linguistiques apparues plusieurs siècles avant que cette langue commençât d'être écrite. La différenciation phonétique de l'article avec les pronoms correspondants s'est aussi accomplie de bonne heure.

M. Çabej voit l'ancienneté de l'article postposé de l'albanais dans le fait que, d'après lui, l'article préposé *e* peut être sorti de l'enclitique *e* (*fushë-e*), à un temps où la crase n'avait pas eu lieu dans le groupe *ë+e* qui a donné *a* (*fushë-e fusha*). Pedersen, Barić, Rosetti, Georgiev considèrent aussi comme très ancienne l'origine de l'article postposé en albanais.

Le grec ancien est à exclure comme source éventuelle, parce qu'il a des articles préposés et une structure différente de celle de l'albanais et du roumain. Le vieux macédonien n'entre pas en ligne de compte comme une source dans ce cas pour des raisons historiques et géographiques.

Ainsi il ne reste donc à envisager comme une source de l'article de l'albanais que les deux vieilles langues des Balkans: l'illyrien et le thrace. Les données directes sur la présentation des articles préposés et postposés en illyrien et en thrace manquent. Devant cet état de choses, il ne reste que la possibilité d'utiliser les

données indirectes de l'illyrien et du thrace. Une telle donnée doit être cherchée, à notre avis, dans la structure d'un groupe ou d'un composé, formé par un substantif et un attribut. Cela fait, Gjinari envisage aussi l'article postposé de l'albanais et du roumain comme issu d'un groupe semblable: c'est dans le cadre de la formule substantif+attribut (adjectif) que l'envisagent pour l'albanais Pedersen, Çabej, Rosetti, Graur, Mirčev, et pour le roumain Graur, Rosetti, Mirčev et Coțeanu, mais ce dernier dans la formule substantif+attribut (nom au génitif). Ce genre de formule se rencontre également en bulgare dans des exemples tirés du vieux bulgare. V. Pisani trouve l'origine de cet article, pour les langues de l'Europe possédant des articles postposés dans un substrat très ancien, dont le trait propre a été de placer le déterminant après le déterminé. Une telle structure est pour l'albanais un trait spécifique, à ce qu'il semble il s'agit même d'une qualité constitutive propre. Cette structure est commune aussi au roumain, à la différence du latin et des langues néolatines.

Si l'on s'adresse au thrace, on constate que les composés de cette langue ont une structure plaçant le déterminant avant l'élément déterminé (*Drizu+para, Mese/m/+bria*, etc.), c'est-à-dire qu'il rentrent dans la formation *attribut + substantif*, tout comme en grec, russe, allemand, etc.

Cette structure écarte l'albanais du thrace (sur ce point aussi le roumain se rapproche de l'albanais), du fait qu'en albanais on trouve une structure dans un ordre inverse soit dans des composés comme *gushëkuq, Gruemirë*, etc., soit dans des groupes de mots: *Guri i bardhë, njeri i mirë*, etc.

Comme conclusion, Gjinari croit que du moins le thrace (y compris le dacomygien) ne puisse pas représenter l'ancienne langue des Balkans dans laquelle on doit chercher l'origine de l'article postposé de l'albanais. Une fois exclu le thrace, on doit soupçonner l'illyrien. On pourrait ajouter aussi un autre point pour soutenir les preuves apportées par la linguistique, l'histoire, l'archéologie et l'ethnographie comme argument à la thèse qui considère l'albanais lié à l'illyrien du point de vue de la filiation et les Albanais comme autochtones dans la zone des Balkans où ils vivent encore aujourd'hui.